



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning



Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
Kosovska Agencija za Zaštitu Sredine
Kosovo Environmental Protection Agency

**Mjedisi në shtypin ditor
(Hulumtim)**



Prishtinë
Janar , 2009



PËRMBAJTJA:

1. HYRJE
2. QËLLIMI I HULUMTIMIT
3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT
4. OBJEKTI (CAKU) I HULUMTIMIT
5. TREGUESIT (INDIKATORËT) E HULUMTIMIT
6. REZULTATET E HULUMTIMIT
7. PËRFUNDIMI
8. VAZHDIMËSIA



1. Hyrje

Krahas problematikave tjera të cilat trajtohen në mediat e shkruara, hapësirë të caktuar zë edhe pasqyrimi i problematikave mjedisore.

Fakti se problemet mjedisore janë probleme të shoqërisë sonë, ka bërë që këto tema të trajtohen gjithnjë e më shumë në mediat e shkruara. Mirëpo, duhet cekur se në Kosovë çështjet mjedisore nuk trajtohen si probleme me prioritet. Problemet mjedisore nuk mbulohen nga gazetarët që janë të specializuar në këtë fushë, prandaj mungojnë njohuritë e duhura për t'i trajtuar në mënyrë profesionale këto probleme. Problematikat mjedisore janë probleme multidisiplinare që kërkojnë një përkushtim më të veçantë dhe një hulumtim më profesional. Mungesa e informacionit të mjaftueshëm, të besueshëm dhe të siguarur me kohë është edhe një tjetër fakt që ndikon në cilësinë e informacionit për mjedisin. Problemet mjedisore janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe çdo problem që lind në një drejtim sjell pasoja edhe në aspekte të tjera mjedisore, duke ndikuar ndjeshëm në shëndetin e njerëzve dhe në mirëqenien e tyre.

Trajtimi i këtyre problemeve në media, jo vetëm në mënyrë informative, por edhe në mënyrë analitike, kritike, hulumtuese dhe edukativ, rrit ndikimin në zgjidhjen e këtyre problemeve, dhe reflekton në qasjen më serioze në zgjidhjen e problemeve mjedisore.

Nga të dhënat e paraqitura në këtë hulumtim vërehet se prania e artikujve mjedisorë, krahasuar me artikujt e fushave që botohen në shtypin e shkruar, mbetet e ulët, por nuk mungon.



2. Qëllimi

Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit në kuadër të aktiviteteve dhe angazhimeve të Drejtorisë së Raportimit, që nga muaj janar i vitit 2008 ka hulumtuar shtypin ditor, me qëllim që të pasqyroj kontributin e tyre në informacionin mjedisor.

Përmes këtij hulumtimi ne synojmë:

- Të fitojmë një pasqyrë të qartë për problematikat më të trajtuara mjedisore, sektorët, nivelin dhe karakterin e artikujve mjedisorë.
- Të dhënat e fituara, t'i marrim parasysh edhe gjatë aktiviteteve tona.
- Të zhvillojmë partneritet të qëndrueshem me mediat për problemet mjedisore;



3. Caku (objekti) i hulumtimit

Objekt (cak) i hulumtimit kanë qenë mediat e shkruara ditore:

- Koha Ditore
- Zëri
- Kosova Sot
- Express
- Lajm
- Infopress
- Epoka e Re
- Bota Sot



4. Metodologjia dhe periudha e hulumtimit

Artikujt mjedisorë në mediat janë identifikuar gjatë ditëve të punës. Materialet janë lexuar dhe sistemuar me kujdes duke i kategorizuar ata sipas tipeve. Nuk është trajtuar aspekti vëllimor i tyre. Periudha e hulumtimit është janar-dhjetor 2008. Nëse marrim parasysh faktin se gjatë këtyre ditëve nuk botohen të gjitha gazetatat ditore, atëherë mund të nxirret një përfundim se hulumtimi ynë ka përfshirë rreth 80% te materialit.

5. Treguesit (indikatorët) e hulumtimit

Treguesit e këtij hulumtimi (monitorimi) janë:

- Numri i përgjithshëm i artikujve për mjedisin;
- Numri i artikujve sipas muajve;
- Numri i artikujve sipas problematikave të trajtuara;
- Numri i artikujve sipas karakterit (tipi) të temës së trajtuar;
- Numri i artikujve sipas nivelit të trajtimit;
- Numri i artikujve për mjedisin sipas sektorëve.



6. Rezultatet e hulumtimit


6.1. Numri i artikujve sipas muajve

Nga hulumtimi i zhvilluar në 8 gazetat e pavarura të shtypit të përditshëm kosovar, për periudhën janar-dhjetor të vitit 2008, rezulton se numri i përgjithshëm i artikujve mjedisorë të paraqitur nëpër këto gazeta është 1476 artikuj. Gjatë muajve qershor (267) dhe korrik (242) numri i artikujve dhe informacioneve për mjedisin ka qenë më i lartë, ndërsa gjatë shkurtit (62) dhe tetorit (73) më i ulët.

(Tabela 1 dhe Grafiku 1).

Tabela 1: Numri i artikujve sipas muajve

Muaji	Numri i artikujve
Janar	94
Shkurt	62
Mars	80
Prill	92
Maj	126
Qershor	267
Korrik	242
Gusht	144
Shtator	88
Tetor	73
Nentor	87
Dhjetor	124



Grafiku 1. Numri i artikujve mjedisorë sipas muajve

Mjedisi në shtypin ditor




6.2. Numri i artikujve sipas problematikave të trajtuara

Pasqyra e shpërndarjes së artikujve sipas tematikës mjedisore, të paraqitura në shkrime, tregon se uji me 371 artikuj dhe mbeturinat me 304 artikuj janë trajtuar më së shpeshti. Problemet e ndotjes së ajrit me 42 artikuj si dhe aktivitetet e shoqërisë civile me 35 artikuj, janë temat me pak të trajtuara nga mediat. (Tabela 3 dhe Grafiku 3).

Tabela 2: Numri i artikujve sipas problematikave të trajtuara

Problematika	Numri i artikujve
Uji	371
Ajri	42
Toka	51
Pyjet	118
Biodiversiteti	103
Sipërfaqet e gjelbra	74
Mbeturinat	304
Infrastrukturë mjedisore	216
Shoqëria civile	35
Ndryshimet klimatike	50



Grafiku 2 : Numri i artikujve sipas problematikave mjedisore




6.3. Numri i artikujve sipas karakterit (tipit) të temës së trajtuar

Sa i përket tipit të temës së trajtuar, nga hulumtimi ynë del se pjesa më e madhe e artikujve janë të karakterit informativ, me gjithsej 652 shkrime, pastaj vend të rëndësishëm zënë problematikat mjedisore me 444 ndersa fusha e investimeve mjedisore trajtohet në 187 artikuj. Më pak të trajtuara janë temat me karakter publicistik dhe legjislativ. Edhe tematika me përmbajtje edukative nuk është prekur në nivelin e duhur, për arsye se gazetarët priren më shumë rreth lajmeve që bëjnë bujë dhe kanë një sasi informacioni brenda tyre, dhe u kushtojnë më pak rëndësi aspekteve ndërgjegjësuere të një aktivitetit që zhvillohet në fushën e mjedisit. (Tabela 4 dhe Grafiku 4).

Tabela3: Numri i artikujve sipas karakterit (tipit) të temës së trajtuar

Tema	Numri i artikujve
Informative	652
Ndërgjegjësim-Edukim	87
Problematike	444
Aktivitete	52
Botime/Publikime	6
Investime	187
Legjislacion	13
Opinion/Koment/Intervistë	35



Grafiku3. Numri i artikujve sipas karakterit (tipit) të temës së trajtuar




6.4. Numri i artikujve sipas nivelit të trajtimit

Hulumtimi nxjerr në pah se problemet mjedisore të nivelit lokal kanë zgjuar interesim më të madh të medimeve të shkruara (830 artikuj), ndërkohë që problemet kombëtare kanë pasur një trajtim mesatar (458 artikuj), ato globale (65) dhe rajonale (105), kanë qenë me pak të trajtuara. (Tabela 5 dhe Grafiku 5).

Tabela 4. Numri i artikujve sipas nivelit të trajtimit

Niveli	Numri i artikujve
Global	65
Rajonal	105
Nacional	458
Lokal	830



Grafiku 4: Numri i artikujve sipas nivelit të trajtimit




6.5 Numri i artikujve për mjedisin sipas sektorëve

Urbanizimi dhe Shërbimet Publike janë sektorët që më së shpeshti janë ndërlidhur me problemet mjedisore sipas artikujve të prezantuar në mediat e shkruara. Edhe ndikimi mjedisor i sektorit të Energjisë dhe i sektorit të Pylltarisë kanë pasur artikuj të mjaftueshëm, ndërkohë që ndikimet mjedisore të sektorit të Transportit, kanë pasur numrin më të vogël të artikujve. (Tabela 6 dhe Grafiku 6)

Tabela 5: Numri i artikujve për mjedisin sipas sektorëve

Sektori	Numri i artikujve
Energjetika	108
Bujqësia	31
Pylltaria	111
Industria	115
Transporti	9
Shëndetësia	72
Turizmi	71
Urbanizëm/Shërbime Publike	427
Tjetër	114



Grafiku 7: Numri i artikujve për mjedisin sipas sektorëve



7.Përfundimet

- Temave mjedisore në gazetate ditore ende nuk iu jepet hapësirë e mjaftueshme;
- Trajtimi i mjedisit në shtypin ditor kryesisht është me karakter reagues ndaj problemeve që shfaqen;
- Rrallëherë gjenden artikuj mjedisorë në faqet e para të gazetave;
- Ka shumë pak gazetarë të profilizuar që merren vetëm me problematikat mjedisore;
- Në krahasim me totalin e artikujve mjedisorë ka pak artikuj hulumtues dhe komente për shkaqet e problemeve;
- Dominojnë temat mjedisore me karakter lokal, ndërsa fare pak trajtohen ato me karakter global;
- Dominojnë artikujt për ujin dhe mbeturinat, fare pak shkrime ka për ajrin dhe tokën;
- Sektori i urbanizimit/shërbimeve publike dhe ai i Energjetikës, janë sektorët më të ndërlidhur me problem mjedisore, që prezantohen në mediat e shkruara ditore.
- Dominojnë artikujt me përmbajtje informative, aktivitete dhe probleme të përditshme të mjedisit.



8. Vazhdimësia e hulumtimit

AKMM, në kuadër të aktiviteteve të saj, do të realizojë edhe hulumtime të tjera të ngjashme.

Shpresojmë që kjo nismë do të jetë vetëm një shkëndijë e vogël në zgjidhjen e problemeve të mëdha mjedisore që ka Kosova.

Falënderojmë të gjitha mediat, për kontributin e dhënë në sensibilizimin e opinionit për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.



Hulumtimin e realizuan:

Riza Hajdari

Afrim Berisha

Tone Gashi

Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

Rr. "Bill Clinton" Nr. 18 Prishtinë;

Tel. +381 38/ 227- 026; +381 38/227-027; Tel/Fax. +381 38 211 685

<http://www.ks-gov.net/akmm>

Prishtinë

Janar 2009